



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Histori e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 20 leksione, 20 seminare

Viti / Semestri : Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: adritik.derjaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon mësimin e historisë së gjuhës turke nëpërmjet elementëve kulturorë dhe gjuhësorë. Lënda është e organizuar në leksione dhe seminare dhe shërben si lëndë për të zhvilluar kompetencat gjuhësore dhe kulturorë të studentëve në gjuhën turke nëpërmjet njohjes me periudha të ndryshme të letërsisë turke, llojet e veprave dhe përfaqësuesit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore të tilla si të mësojë për kulturën, për gjuhën dhe për letërsinë turke.

2. Të lidhë informacionin gjuhësor të nivelit të mëparshëm gjuhësor me informacionin e ri që mëson për kulturën dhe letërsinë turke.

Rezultatet e pritshme:

1. Njohë dhe analizojë elementët themelore të historisë së gjuhës, kulturës dhe letërsisë turke, duke identifikuar periudhat kryesore dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm.

2. Lidhë dhe integrojë njohuritë gjuhësore ekzistuese me njohuri të reja kulturore dhe letrare, duke zhvilluar një kuptim më të thellë dhe të ndërthurur të gjuhës turke në kontekst historik e kulturor.

3. Zhvillojë kompetenca gjuhësore dhe kulturore nëpërmjet analizës së veprave letrare, diskutimeve në seminar dhe përfshirjes aktive në temat e trajtuara gjatë kursit.